

**KONTRATË DHURIM AKSIONESH**  
**TË SHOQËRISË TREGTARE**  
**“PLUS COMMUNICATION” sh.a**

Sot më datë 10.10.2020 (dymijë e njëzet), ne palët e mëposhtme:

**PALA DHURUESE**

**Fatmir Paçuku**, atësia Medat, datëlindja 31.08.1955, lindur dhe banues në Tiranë, rruga “Naim Frashëri”, Pallati nr. 60/1, Apartamenti nr. 11, titullar i letërnjoftimit me nr. personal F50831035U.

**PALA PRANUESE E DHURIMIT**

**Elson Spahiu**, atësia Naim, datëlindja 16.01.1985, lindur dhe banues në Tiranë, rruga “Ali shefqeti”, Shkozë, titullar i letërnjoftimit me nr. personal I50116040J.

**PËRMBAJTJA E KONTRATËS**

Pala dhuruese e aksioneve **Fatmir Paçuku** është aksioner në shoqërinë “**PLUS COMUNICACION**” sh.a, e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar në datën 10.06.2009, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër Nipti K91811014B, me seli në Tiranë, Farkë, Rruga "Shyqyri Brari", Ndërtesa Nr. 2, Dyqani Nr. 18, me kapital themeltar 266.430.050,00 lekë(dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e katërqind e tridhjetë mijë e pesëdhjetë lekë), ndarë në 225.788.185,00(dyqind e njëzet e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë) aksione me vlerë nominale 1.18 (një pikë tetëmbëdhjetë)lekë secila.

Pala dhuruese është zotëruese e ,00 % të aksioneve të kapitalit themeltar të shoqërisë dhe dëshiron t'i dhurojë palës pranuese të dhurimit të gjitha aksionet, e konvertuar në 3514.0000 të drejtë vote.

Pala pranuese e dhurimit pranon dhurimin e ,00% të aksioneve të zotëruara nga dhuruesi dhe bëhet aksionere e shoqërisë.

**NENI 1**

**OBJEKTI I KONTRATËS**

Pala dhuruese **Fatmir Paçuku** dëshiron t'i dhurojë palës pranuese të dhurimit **Elson Spahiu** dhe pala pranuese e dhurimit pranon dhurimin në favor të saj të ,00 % të aksioneve të shoqërisë, e konvertuar në 3514.0000 të drejtë vote.

**NENI 2**

**TRANSFERIMI I KAPITALIT**

1. E drejta e pronësisë mbi aksionet që i dhurohen nga pala dhuruese, i kalon palës pranuese të dhurimit në momentin e nënshkrimit të kontratës.
2. Pala dhuruese i dorëzon palës pranuese të dhurimit të gjitha dokumentat, deklaratat, ose çertifikatat e nevojshme për përfundimin e transferimit të aksioneve të shoqërisë në favor të palës pranuese të dhurimit dhe për regjistrimin e këtij tranferimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
3. Në momentin e transferimit të Aksioneve, pala pranuese e dhurimit **Elson Spahiu** bëhet aksionere e shoqërisë “**PLUS COMUNICACION**” sh.a dhe njëkohësisht zotëruese e ,00% të aksioneve të kapitalit themeltar të shoqërisë, ndërsa **Fatmir Paçuku** largohet nga shoqëria.

**NENI 4**



## DEKLARATA DHE GARANCI

Pala dhuruese deklaron dhe garanton palën pranuese të dhurimit për sa më poshtë vijon:

1. Pala dhuruese është pronare e ligjshme e aksioneve që i dhuron nga palës pranuese të dhurimit, të cilat janë të nënshkruara dhe të paguara plotësisht.
2. Shoqëria ka dorëzuar të gjitha deklaratimet e raportimet e tatimeve që kërkohen të dorëzohen sipas ligjit dhe ka paguar të gjitha vlerësimet tatimore, tarifat dhe detyrime të tjera shtetërore për Shoqërinë tek të tretët, pasurinë e të ardhurat e saj, që sipas ligjit janë të detyrueshme për t'u paguar;
3. Pala pranuese e dhurimit deklaron se merr përsipër çdo detyrim ligjor dhe/ose financiar që mund të rëndojë mbi shoqërinë para datës së nënshkrimit të kontratës.
4. Shoqëria nuk është në shkelje të ndonjë marrëveshjeje me të cilën është palë;
5. Shoqëria nuk është palë, as nuk është në dijeni të ndonjë rreziku për ndjekje gjyqësore, arbitrazhi, apo administrative, rezultati i së cilës mund të kishte efekt material negativ për dhurimin e aksioneve të shoqërisë.
6. Pala pranuese e dhurimit deklaron se ka bërë verifikimet pranë RBS, dhe se aksionet që dhurohen janë të lira nga cdo detyrim ndaj shtetit apo të tretëve.

### NENI 5

#### DETYRIMET TATIMORE

Pala pranuese e dhurimit **Elson Spahiu** pranon të përfitojë ,00 % të aksioneve; me gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të bilancit të shoqërisë deri në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate. (Dhuruesi deklaron se shoqëria nuk ka detyrime financiare ndaj shtetit dhe të tretëve).

### NENI 6

#### KUSHTE TË PËRGJITHSHME

Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Palëve në lidhje me këtë Kontratë, ose çdo marrëveshje tjetër, ose dokument të zbatuar midis palëve për zbatimin e kësaj Kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim midis Palëve, përndryshe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë midis Palëve, në lidhje me çështjet që trajton dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme, qoftë me gojë apo me shkrim, midis palëve.

Pavlefshmëria ose pabazueshmëria e njëres nga dispozitat e kësaj Kontrate nuk do të çënojë vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e dispozitave të tjera. Dispozita e pavlefshme do të zëvendësohet me një marrëveshje ligjrisht të vlefshme, që korrespondon sa më shumë të jetë e mundur me synimet e palëve.

### NJOFTIMET

Të gjitha njoftimet dhe komunikime mes palëve do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen si të dhëna në mënyrë të rregullt nëse i dorëzohen në dorë, i dërgohen me postë të regjistruar ose me faks palës në adresën e paracaktuar nga Palët.

### DISPOZITA E FUNDIT




Kjo Kontratë është nënshkruar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe me të njëjtën vlerë secila. në bazë të nenit 761 e vijues të Kodit Civil dhe të Ligjit “Për noterinë” si edhe të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

**PALET**

**PALA DHURUESE**

**Fatmir Paçuku**

Fatmir Paçuku  


**PALA PRANUESE E DHURIMIT**

**Elson Spahiu**

Elson Spahiu  
